

VENDIM
Nr. 55, datë 3.3.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “GREEN ENERGY BILISHTI” SHPK SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 999/2 prot., datë 28.2.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Green Energy Bilishti’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen barrës siguroese mbi kuotat e saj si mjet për garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj ‘Raiffeisen Bank’ sh.a.”.

konstatoi se:

- Shoqëria “Green Energy Bilishti” sh.p.k është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 194, datë 21.7.2022, i ndryshuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 207/6 prot., datë 12.3.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen e barrës siguroese mbi kuotat e saj si mjet për garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

- ERE me shkresën nr. 207/7 prot., datë 3.4.2024, i ka kërkuar shoqërisë informacionin/ dokumentacionin konstatuar të munguar nga ky aplikim, që konsiston në deklarin nëse kërkohet që dokumentacioni/ informacioni i depozituar të mos jetë i hapur për publikim; përshkrimin mbi arsyet e vendosjes së kuotave si mjet garantimit për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve; deklaratën përkatëse që këto kuota nuk janë vendosur si mjete garantimi për një detyrim tjetër, kontratën paraprake të kredisë; njoftimin/korrespondencën me MIE-n; si dhe nëse ka pasur vendim gjyqësor të mëparshëm.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 207/8 prot., datë 25.4.2024, shoqëria ka depozituar sa kërkuar në lidhje me kërkesat e rregullores, por konstatojmë se deklarata noteriale e përcjellë e datës 12.3.2024, ku deklarohet se garantohet kthimi i kuotave në gjendjen e mëparshme në rast se ERE nuk miraton autorizimin, është nënshkruar nga administratori, por në referencë të natyrës së këtij deklarimi duhet të jetë i nënshkruar nga vetë ortaku që zotëron 100% të kuotave të shoqërisë.

- ERE nëpërmjet shkresës nr. 207/9 prot., datë 20.5.2024 si dhe e-mailit nr. 207/10 prot., datë 15.7.2024, i ka risjellë në vëmendje shoqërisë detyrimin e depozitimit të saktë të deklaratës noteriale.

- Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin që është nënshkruar një marrëveshje me “Raiffeisen Bank” sh.a., pa marrë më parë autorizimin e ERE-s, lindi nevoja për të sqaruar qëndrimin nga banka, si e tillë u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore në datën 18.11.2024, në ambientet e ERE-s, e cila u njoftua nëpërmjet shkresës me nr. 207/12 prot., datë 6.11.2024.

- Shoqëria i është drejtuar ERE-s duke i bërë me dije pamundësinë për të qenë prezent në seancën dëgjimore, ndaj ERE në vijim me e-mailin protokolluar nr. 207/14 prot., datë 17.12.2024,

duke i kërkuar dakordësinë mbi një datë në të cilën mund të jenë prezent, por nuk ka pasur asnjë përgjigje, e si e tillë, ERE ka zhvilluar seancën me përfaqësuesit e “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Në vijim të seancës, me shkresën nr. 212/15 prot., datë 26.12.2024 “Raiffeisen Bank” sh.a. ka përcjellë qëndrimin/dokumentacionin e kërkuar.

- Në vijim, ERE me shkresën nr. 999 prot., datë 7.2.2025 i është drejtuar shoqërisë duke i rikujtuar detyrimin për të përcjellë deklaratën e firmosur nga ortaku i shoqërisë, mbi kthimin e kuotave në gjendjen e mëparshme në rast të mos marrjes së autorizimit nga ERE. Në përgjigje me shkresën nr. 999/1 prot., datë 10.2.2025 shoqëria ka përcjellë sa kërkuar.

- Shoqëria ka shlyer detyrimet për pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Green Energy Bilishti” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Green Energy Bilishti” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Green Energy Bilishti” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Green Energy Bilishti” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti